



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:088343

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05511075

Ac.nr.9211/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: B.B., M.B., K.B., H.B., dhe A.B-R., që të gjithë nga Ferizaji, të cilët me autorizim i përfaqëson J.B., avokat nga Ferizaji, kundër të paditurës B..... K..... e S..... me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson L.RR., dhe të paditurit V.T., nga fshati Ll....., Komuna e Lipjanit, për çështjen kontestuese kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditurit V.T., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.395/2019 të datës 22.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurit V.T., nga fshati Ll....., Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.395/2019 i datës 22.09.2021, në pikën III (tre) të dispozitivit lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të përjetimit të dhimbjeve fizike dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, **NDRYSHOHET** dhe gjykohet: detyrohet i padituri V.T., nga fshati Ll....., Komuna e Lipjanit, që paditëses A.B-R., nga Ferizaji, që në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike t'ia paguaj shumën prej 4,500.00 €, dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, t'ia paguaj shumën prej 4,000.00 €, pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara për këto forma të dëmit refuzohet si e pabazuar. Sa i përket dëmit material, **NDRYSHOHET** dhe gjykohet: **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses A.B-R., nga Ferizaji, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri V.T., nga fshati Ll....., Komuna e Lipjanit, që në emër të dëmit material, për shpenzime të shërimit t'ia paguaj shumën prej 650 €, dhe për rehabilitim klimaterik, t'ia paguaj shumën prej 350 €, **NË TËRËSI E PA THEMELTË**.

II.REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit V.T., nga fshati Ll....., Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.395/2019 të datës 22.09.2021, përveç pjesës së ndryshuar dhe të refuzuar, **VËRTETOHET**, përveç në

pikën III (tre) të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë ndryshohet dhe vendoset, ashtu që **DETYROHET** i padituri që paditësve t'ua paguaj kamatën për të gjitha format e dëmit jo material dhe material, në lartësi të kamatës të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 07.09.2021, e deri në pagesën definitive.

III. Pika IV, V, VI, VII DHE VIII e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.395/2019 të datës 22.09.2021, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.395/2019 të datës 22.09.2021, në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësve: B.B., M.B., K.B., H.B. dhe A.B-R., të gjithë nga Ferizaji, kundër të paditurit V.T. nga fshati Ll....., Komuna e Lipjanit. Në pikën dy të dispozitivit e ka detyruar të paditurin V.T., që paditësve të theksuar si në pikën I - të dispozitivit, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, si pasojë e humbjes së anëtarëve të tyre të familjes, R.B., dhe A.B., në aksidentin e komunikacionit të datës 11 nëntor 1999, t'u paguaj paditësve shumat si në vijim:

- Paditësve - prindërve: shumën e përgjithshme prej 25,750.00 €, dhe atë për dëmin jo material si pasojë e dhimbjeve shpirtërore nga 12,000.00 €, dhe për dëmin material, në emër të shpenzimeve të varrimit 1,500.00 € dhe në emër të ndërtimit të përmendores 250.00 €.

- Paditësve: K.B., H.B., dhe A.B-R., (vëllezërit dhe motra); shumën e përgjithshme prej 18,000.00 € (tetëmbëdhjetëmijë euro) dhe atë për dëmin jo material si pasojë e dhimbjeve shpirtërore secilit paditës nga 6,000.00 €.

Në pikën tre të dispozitivit e ka detyruar të paditurin V.T., që paditëses A.B-R., në emër të dëmit material dhe jo material si pasojë e lëndime trupore nga aksidenti i komunikacionit të datës 11 nëntor 1999, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 15,350.00 € dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej 5.500 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 6.000 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.500 €, për ndihmën e huaj 200 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 150 €, për shpenzime të shërimit shumën prej 650 €, për rehabilitim klimaterik shumën prej 350 €. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (7 shtatori 2021) deri në pagesën definitive, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim për paditësit do të shërbejë si titull ekzekutiv dhe si i tillë është i përmbarueshëm. Në pikën katër të dispozitivit e ka detyruar të paditurin V.T., që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ua paguaj paditësve të përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit, shumën prej 1,496.00 €, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Në pikën pesë të dispozitivit është refuzuar e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve, përtej shumave të aprovuara, në shumë prej 61,250.00 €, për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasojë humbjes së anëtarëve të tyre të familjes. Në pikën gjashtë është refuzuar e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses A.B-R., përtej shumave të aprovuara si në pikën III të dispozitivit dhe atë shuma prej 26,466.75 €. Në pikën shtatë të dispozitivit është refuzuar kërkesa e paditësve, lidhur me shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3.622 €, përtej shumës së aprovuar

si në pikën IV të dispozitivit. Në pikën tetë është refuzuar e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve, me të cilën kanë kërkuar kompensim dëmi nga e paditura B..... K..... e S..... me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i padituri V.T., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ta aprovoj ankesën e paditësit, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën të kthej në rigjykim apo ta ndryshoj aktgjykimin ankimor dhe të refuzoj kërkesëpadinë e paditësve, si kërkesë e parashkruar.

Ankesa e të paditurit i është dërguar të autorizuarit të paditësve, të cilën e ka pranuar me datë 25.10.2021, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar, në gjykatën e shkallës së parë kanë ushtruar padi me datë 10.04.2019, për shkak të kompensimit të dëmit, kundër të paditurve: B..... K..... e S..... dhe V.T., me të cilën kanë kërkuar që secili të kompensohet për dëmin jo material për dhimbje shpirtërore dhe shpenzime të varrimit dhe ngritjes së përmendores për shkak të humbjes së jetës së djalit, vajzës, përkatësisht vëllait-motrës të paditësve, konkretisht të ndjerit R., dhe A.B., ndërsa në mënyrë të veçantë paditësja A.B-R., ka kërkuar kompensim dëmi për gjitha format e dëmit si pasojë e lëndimeve nga aksidenti i komunikacionit të datës 11.09.1999, sipas kërkesës së precizuar me datë 08.07.2021. Tutje paditësit përmes të autorizuarit, kanë theksuar se e paditura e parë BKS në Prishtinë, ka legjitimitet të palës në këtë çështje sipas dispozitave të LMD-së, sepse e drejta për kompensim dëmi paditësve nuk është krijuar me datë 11.09.1999, në kohën kur ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, por me datë 12.02.2019, në kohën në të cilën është konfirmuar përgjegjësia e të paditurit V.T., i cili në kohën kur e ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit e që për këto raste sipas ligjit nga auto përgjegjësia përgjigjet e paditura e parë, ndërsa përgjegjësinë ligjore objektive të paditurës së parë e ka përcaktuar edhe neni 130 të LMD-së, i cili ka përcaktuar detyrimet e pas ardhësve juridik për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga paraardhësit e tyre. Megjithatë ka shtuar se, nëse gjykata nuk gjen se e paditura e parë nuk mund të konsiderohet përgjegjëse, të detyrohet i padituri i dytë, që paditësve për të gjitha kategoritë e dëmit t'ua paguaj paditësve shumë si në precizimin e padisë. Në lidhje me lartësinë e kërkesës së paditësve, paditësit kanë konsideruar se kërkesa e tyre bazohet në rregulloren e BQK-së së datës 31.08.2016 dhe nga praktika gjyqësore si dhe në standardin jetësorë.

E paditura e parë - BKS, përmes përfaqësuesit të saj, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve sepse të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv, për shkak se aksidenti i komunikacionit ka

ndodhur më 11 nëntor 1999, dhe BKS nuk ka qenë e krijuar si institucion në atë periudhë kohore dhe në këtë kontest e paditura nuk ka detyrim ligjor për trajtim dhe kompensimin e dëmeve, duke i propozuar gjykatës që në raport me të paditurën e parë, kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

I padituri i dytë, V.T., në seancën e shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se lidhur me këtë ngjarje ka pasur një marrëveshje jashtë gjyqësore sipas së cilës i ka dhënë paditësit B.B., shumën e të hollave prej 3000 €, e që mbi këtë arsye ka menduar se e ka kryer obligimin ndaj paditësit, andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar.

Duke vepruar sipas padisë së paditësve, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditësve, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave si: aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Ferizaj P.nr.1154/17; Kopja e certifikatës se vdekjes për R.B., me numër te referencës X/XX RV/XXXX nr. Rendor XXX e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prishtinë me datë 11.02.2019; Kopja e certifikatës se vdekjes për A.B., me numër te referencës XX/XXX RV/XXXX nr. Rendor XXX e lëshuar nga zyra e gjendjes civile ne Prishtinë me date 11.02.2019; Kopja e deklaratës se bashkësisë familjare me numër F XXXX lëshuar nga zyra e gjendjes civile ne Ferizaj me datë 28.12.2018; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit psikiatër Dr. M.A., i dt. 26.03.2021; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit Ortoped Dr. B.I., i dt. 20.03.2021 dhe dëshmia e dëshmitarit H.A., nga Ferizaj. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të bazës së kërkesëpadisë e cila është kontestuar nga e paditura, ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit material dhe kamatës duke u bazuar në dispozitën e neni 136, 140, 169, 174, 201 dhe 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë nga ana e të paditurit, për shkelje të dispozitave kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale sa i përket pjesës së aprovuar të kërkesëpadisë së paditëses A.B-R., lidhur me dëmin jo material, dhe jo me arsyetim të gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për secilën kategori të dëmit. Aktgjykimi nuk është i përfshirë as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Lidhur me gjendjen faktike, Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës del se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurit është vërtetuar nga aktgjykimi penal P.nr.1154/17 i datës 14.11.2018 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, me të cilin i padituri është shpallur fajtor për veprën penale ‘‘Veprat e rënda kundër sigurisë së komunikacionit’’, dhe i padituri V.T., për këtë veprë penale ka vuajtur dënimin e shqiptuar. Sa i përket përgjegjësisë së të paditurit për kompensimin e dëmit paditësve pavarësisht se i padituri gjatë zhvillimit të procedurës e ka kontestuar bazën juridike të kërkesë padisë, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se vet pala e paditur në deklaratimet e tija dhe në ankesë ka theksuar se lidhur me aksidentin e ndodhur palët paditëse i ka kompensuar me një shumë prej 3.000 €, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se, bazuar në këtë dhe shkresat tjera të lëndës baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve nuk është kontestuese.

Lidhur me pjesën e ndryshuar si në pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses A.B-R., e ka vërtetuar shumën e kompensimit të aprovuar në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, sa i përket kompensimit të dëmit jo material në emër të frikës së përjetuar, duke refuzuar si të pathemeltë ankesën e palës së paditur dhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar sa i përket kompensimit të dëmit jo material në emër të përjetimit të dhimbjeve fizike dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të rënda trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, intensitetin e tyre, që për pasoj paditësja ka pësuar zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor (në shkallë prej 13%), është vendosur që të ndryshohet dhe gjykohen shumë e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar për këto kategori, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 200 par.2 të LMD-së, (Gazeta Zyrtare 1978) i cili decidivisht thotë se: *‘‘Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkoj për përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror’’. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfacion të vërtetë, për aq sa është e mundur,*

duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur mbi shumën në emër të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë, siç theksohet edhe në ekspertizë mjekësore, paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, të pasur me vitamina, proteina dhe albumina dhe ndihmë të personit të tretë. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t'u vërtetuar me prova konkrete, praktika e Gjykatave të Kosovës e njeh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ushqim të përforcuar, atëherë rrjedhimisht e ligjërisht, paditëses i takon kompensimi për të. Gjykata ankimore e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses A.B-R., si të pabazuar sa i përket dëmit material në emër të shpenzimeve të shërimit dhe rehabilitimit klimaterik, pasi që për të njëjtat shpenzime pala paditëse nuk ka bashkëngjitur prova materiale në bazë të cilëve do të mund të vërtetohej se paditësja ka krijuar shpenzime të shërimit dhe ka qenë në terapi fizikale - rehabilitim.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast e drejta materiale për shumat e caktuara për paditësit në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes të fëmijëve, përkatësisht vëllait dhe motrës, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të shkaktuar me datë 11.11.1999, në Magjistralen Ferizaj - Prishtinë, më saktësisht në fshatin B..... i M....., Komuna Lipjan, është shkaktuar me fajin e të paditurit V.T., i cili është vërtetuar me aktgjykim penal. Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret edhe pa ekspertizën e psikiatrisë e cila është marrë nga gjykata e shkallës së parë për të vlerësuar dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga paditësit për vdekjen e të afërmeve të tyre, një e drejtë e tillë për kompensimin e dhimbjeve shpirtërore është e garantuar edhe me dispozitën e nenit 201 par.1 të LMD-së, ku ndër të tjera është përcaktuar rrethi i personave që mund të kërkojnë një kompensim të tillë. Paditësit hyjnë në rrethin e këtyre personave që dispozita e lartë përmendur ja njeh kompensimin, kështu që mjafton të vërtetohet fakti i vdekjes, afërsisë së personave që kërkojnë kompensim me personin e vdekur, ndërsa gjykata përcakton lartësinë e kompensimit në bazë të bindjes së lirë dhe duke marrë për bazë edhe rrethanat e tjera si mosha e personave të vdekur si dhe afërsinë e personave që kërkojnë kompensim.

Gjykata e Apelit e vlerëson të pa themeltë pretendimin ankimor për aplikim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket pjesës së vërtetuar të aktgjykimit të atakuar, kjo pasi që shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit dhe në përputhje me gjendjen faktike të konstatuar, duke marrë për bazë dhimbjet shpirtërore që kanë përjetuar dhe përjetojnë paditësit, intensitetin e tyre, kështu që shumat e gjykuara i shërbejnë kompensimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 200 dhe 201 të LMD-së, ngase ky aspekt i dëmit jo material përfaqëson satisfaksion moral i cili përjashton kompensimin material, për shkak se me këtë lloj të kompensimit tentohet të arrihet ekuilibri në mes të humbjes përkatësisht të mirës së goditur me dhimbjen e përjetuar shpirtërore të cilën paditësit e kanë përjetuar dhe do ta përjetojnë gjithnjë për shkak të humbjes së anëtarëve të ngushtë të familjes dhe me çfarëdo lartësi të kompensimit kjo humbje nuk mund të plotësohet, andaj vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e vërtetuar aktgjykimin e atakuar dhe refuzuar ankesën e të paditurit.

Në lidhje me lartësinë e kompensimit të caktuar për dëmin material në emër të shpenzimeve të varrimit për të ndjerit R., dhe A.B., kjo gjykatë vlerëson se është në pajtim me nenin 193 të LMD-së, dhe sipas bindjes së lirë duke i marrë parasysh shpenzimet e zakonshme që bëhen sipas traditës tonë gjatë ceremonive të varrimit dhe mbajtjes së të pamës dhe aktivitete të tjera tradicionale.

Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë ka aprovuar ankesën e palës së paditur sa i përket kamatës së gjykuar dhe e ka ndryshuar duke e gjykuar, ashtu që e ka detyruar të paditurin që shumat e gjykuara si në dispozitivin II dhe III të aktgjykimit të atakuar t'ua paguaj paditësve me kamatë vjetore të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit 07.09.2021, e deri në përmbushje definitive, me aplikim të dispozitave ligjore nga neni 277 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (viti 1978) i cili ishte në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit.

Sa i përket pretendimit ankimor të paditurit se në këtë çështje juridike kontestimore është arritur parashkrimi i kërkesës së paditësve marrë parasysh se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 11.11.1999, Gjykata e Apelit nuk e mori parasysh këtë pretendim të paraqitur me ankesë, duke qenë se ky pretendim nuk është paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës në shkallë të parë si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 180 paragrafi 3 e LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *''Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë''*.

Pika IV, V, VI, VII dhe VIII e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi që kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit nuk është atakuar përmes ankesës së ushtruar nga i padituri.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9211/2021, me datë 14.03.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.